

Zhvillohet aktiviteti për të përkujtuar hyrjen në ambasada dhe fillimin e eksodit të shqiptarëve, më 2 korrik 1990



Në përkujtim të 30-vjetorit nga "Eksodi i ambasadave" Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën dhe në bashkëpunim me ambasadën Gjermane zhvilloi një aktivitet për të përkujtuar një ditë të shënuar për historinë e migracionit shqiptar, hyrjen në ambasada dhe fillimin e eksodit të shqiptarëve, më 2 korrik 1990. Aktiviteti u hap me një fjalë përshëndetëse nga ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko. Kjo datë prodhoi një akt që refuzoi atë që ishte dhe pohoi atë ndryshim që do të vinte. Numri i shtetasve shqiptarë me nënshtetësi të huaj po rritet në vendet pritëse. Ata ndryshuan Shqipërinë dhe influenca e tyre është e madhe", u shpreh ministri Majko. Duke u nisur nga rëndësia e kësaj date për vendin dhe historinë e migracionit shqiptar, takimi u përshëndet edhe nga ambasadori gjerman në Shqipëri, z. Peter Zingraf dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj. Në fund të diskutimeve, u përuara edhe një vepër skulpturore kushtuar kësaj ngjarjeje, krijim i artistit Agim Rada.

Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#):

Miratohet vendimi "Për çmimet dhe kategoritë që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, për vitin shkollor 2020-2021"



Me propozimin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr.523, datë 1.7.2020 për "Miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, për vitin shkollor 2020-2021". Sipas këtij vendimi, me qëllim mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në Diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën do të sigurojë, botojë dhe shpërndajë për kategoritë që përfitojnë falas, tekstet shkollore dhe ato plotësuese për vitin shkollor 2020-2021. Mësimi i gjuhës shqipe do të zhvillohet në përputhje me kurrikulën e përbashkët sipas marrëveshjes midis Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Kosovës dhe Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës.

Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"

SHKARKO APLIKACIONIN FALAS



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

QSPA, vizitë studimore në bibliotekat kryesore të qytetit të Shkodrës

Drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA), prof. Diana Kastrati, së bashku me grupin e studiuesve që janë pjesë e këtij institucioni, kanë zhvilluar sot një vizitë studimore në bibliotekat kryesore të qytetit të Shkodrës. Qëllimi i vizitës lidhet me njohjen nga afër të literaturës mbi Arbëreshët, si dhe krijimin e kontakteve të bashkëpunimit për shfrytëzimin e titujve të pasur që ofrojnë këto biblioteka, ndër më të pasurat në vendin tonë. Janë zhvilluar vizita në bibliotekën e Universitetit "Luigj Gurakuqi", si dhe në Bibliotekën Françeskane. Drejtuesit e këtyre bibliotekave kanë mirëpritur studiuesit e QSPA-së dhe iu kanë vënë në dispozicion bazën e të dhënave të titujve të librave të ndryshëm që kanë mbi Arbëreshët.



Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



DIGJITALIZIMI I VEPRAVE SHQIPTARE

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për here të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

QBD takim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Kosovës




U zhvillua takimi zyrtar midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës, Prof. Dr. Ramë Likaj, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës, Agim Berdyna, drejtoreshës së Qendrës së Botimeve për Diasporën znj. Mimoza Hysa dhe përfaqësuesve të stafit të QBD-së. Tema e diskutimit të këtij takimi ishte vijueshmëria e punës së Komisionit të Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën. Ministri Likaj shprehu gatishmërinë e tij të plotë për bashkëpunim, me qëllim përmbylljen sa më shpejt të këtij procesi, duke nisur nga përpilimi i një kalendarit të saktë të punës me data të përcaktuara. Komisioni i Përbashkët Shqipëri-Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën është ngritur në zbatim të marrëveshjes së miratuar midis dy shteteve "Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe mërgatë".

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

QBD publikon falas online fjalorin dygjuhësh për fëmijë, shqip-gjermanisht



Qendra e Botimeve për Diasporën vë në dispozicion të fëmijëve në Diasporë, një tjetër fjalor dygjuhësh për fëmijë: fjalorin shqip-gjermanisht, në formatin e-book. Fjalori, shumë i dobishëm për mësuesit dhe fëmijët në Diasporë dhe jo vetëm, është i shkarkueshëm falas për të gjithë. Fjalori dygjuhësh për fëmijë është konceptuar për fëmijë të moshës deri në 6 vjeç dhe shoqërohet me ilustrime të përzgjedhura me kujdes për t'i qartësuar dhe për t'i konkretizuar edhe më shumë fjalët duke i bërë ato edhe më të kuptueshme për fëmijët. Ky fjalor synon t'u japë fëmijëve të Diasporës një lëndë të pasur për të përmirësuar njohuritë e tyre në gjuhën shqipe, por gjithashtu mund të jetë shumë i vlefshëm edhe në procesin e mësimdhënies. Kliko këtu për ta shkarkuar.

Zhvillohet mbledhja e radhës së këshillit koordinues të QSPA-së



U zhvillua mbledhja e radhës së Këshillit Koordinues të QSPA-së. Këshilli Koordinues i QSPA-së diskutoi dhe miratoi çështjet vijuese: **Së pari**, u miratua dhe legjitimua Këshilli Akademik Teknik Propozues mbi Botimet, i përbërë përkatësisht nga prof. Emil Lafa, prof. Ymer Çiraku dhe prof. Vjollca Osja. **Së dyti**, u miratuan librat studimorë që do të botohen nga QSPA përgjatë vitit 2020, duke u dhënë edhe një sërë sugjerimesh mbi përmirësimet të mundshme të tyre. **Së treti**, u konfirmua nga përfaqësuesja e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Znj. Mira Hoxha se është në proces finalizimi plotësimi i Këshillit Koordinues të QSPA-së me dy përfaqësuesit e komunitetit të Arbëreshëve të Italisë.

QBD marrëveshje bashkëpunimi me FSHZHD-në

Në mjediset e QBD-së, në sallën e mbledhjeve "Fan Noli", drejtoresha e QBD-së, znj. Mimoza Hysa dhe drejtoresha e FSHZHD, znj. Blerina Turdiu firmosën marrëveshje bashkëpunimi midis dy institucioneve. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është se institucionet do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për zhvillimin, plotësimin, zgjerimin dhe promovimin e projektit "Digjitalizimi i Veprave Shqiptare"; ofrimin e përvijës në shërbim të platformës "Digjitalizimi i Veprave Shqiptare"; organizimin e aktiviteteve, seminareve dhe konferencave të përbashkëta për gjuhën, letërsinë dhe kulturën dhe vlerat shqiptare në diasporë; krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm.

